

## SYLLABUS

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Menaxhimi i Projekteve Hoteliere dhe Turistike</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>III</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. As. Dr. Artan Veseli</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:artan.veseli@ushaf.net">artan.veseli@ushaf.net</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>Kjo lëndë ofron një hyrje sistematike dhe të plotë të të gjitha aspekteve të menaxhimit të projektit. Projektet janë një aspekt gjithnjë e më i rëndësishëm i biznesit në industrinë e hotelerisë dhe turizmit. Prandaj, lënda thekson rëndësinë e të kuptuarit të relacioneve midis projekteve dhe qëllimeve strategjike të organizatës. Lënda gjithashtu diskuton aftësitë teknike, kulturore dhe ndërpersonale të nevojshme për të menaxhuar sukseshëm me projektet nga fillimi deri në fund. Lënda thekson se menaxhimi i projektit është një disiplinë profesionale me mjetet e veta, kornizën e njohurive dhe aftësive. Konceptet përforcohen nga rastet studimore që mbulojnë një larmi të gjerë të llojeve të projekteve në industrinë e hotelerisë dhe turizmit.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Kjo lëndë synon të zhvillojë kompetencat dhe aftësitë e studentëve për planifikimin dhe kontrollimin e projekteve në industrinë hotelerisë dhe e turizmit dhe të përmirësojë kuptimin e tyre në çështjet ndërpersonale që nxisin rezultate të suksesshme të projekteve.</p> <p>Gjithashtu, kjo lëndë synon të identifikojë mjetet që përmirësojnë aftësinë e studentit për të planifikuar dhe menaxhuar projekte gjatë gjithë ciklit jetësorë të tyre, nga përcaktimi i fushëveprimit të projektit deri në mbylljen e tij, duke përfshirë metodologjitë e vlerësimit të kohës dhe kostove, si dhe matjen e progresit dhe performancës.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studenti duhet të jetë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kuptojë rëndësinë e menaxhimit të projekteve në industrinë e hotelerisë dhe turizmit dhe të aplikon mjete, modele dhe procese specifike për menaxhim të projekteve.</li> <li>2. Kuptojë rëndësinë e zbatimit të këtyre</li> </ol>

	<p>metodologjiive dhe mjeteve në katër fazat e dallueshme në ciklin jetësor të Projektit (Faza e Inicimit, Planifikimit, Ekzekutimit dhe Mbylljes).</p> <p>3. Demonstrojë përdorimin e teknikave të përshtatshme të skedulimit.</p> <p>4. Kuptojë rëndësinë e vlerave dhe ndryshimeve kulturore, veçanërisht në projektet e hotelerisë dhe turizmit.</p>
--	--

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren (vizitë studimore)			
Kollokfiume, seminare	3	1	3
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	6	3	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	1	3
Projektet, prezentimet ,etj	3	1	3
<b>Totali</b>			<b>125</b>

**Metodologjia e mësimdhënies:**

Lënda do të zhvillohet në kohëzgjatje prej 15 javësh, me 2 orë ligjerata në javë, ku do të trajtohen konceptet teorike dhe do të jepen shpjegime në lidhje me proceset e menaxhimit të projektit, dhe 1 orë në ushtrime grupore.

Të mësuarit duhet të jetë një përvojë aktive dhe e vetë-motivuar. Studentëve u rekomandohet fuqimisht të kenë një kuptim të përditësuar të zhvillimeve që lidhen me këtë lëndë dhe që lidhen me programin e tyre të gjerë të studimit. Të mësuarit në mënyrë aktive do të rezultojë pasurues për lëndën në përgjithësi dhe diskutimet në klasë. Studentët do të inkurajohen të thellojnë kuptimin e tyre si të çështjeve teorike ashtu edhe të çështjeve aktuale nga një larmi burimesh.

Materiali i lëndës përbëhet nga prezantime të ndryshme në Powerpoint, shënime ligjeratash dhe

	<p>lexime nga librat. Prezantimet në Powerpoint do të bëhen të disponueshme pasi të jenë mbajtur klasat përkatëse.</p> <p>Planprogrami, prezantimet e Powerpoint-it dhe materialet e rëndësishme do të ngarkohen në Sistemin e Menaxhimit të Universitetit (SMU). Studentët pritet të vizitojnë këtë platformë rregullisht për të qenë në hap me zhvillimet e lëndës. Profesori pritet të ngarkojë materialin përkatës në kohën e duhur.</p>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Prezantimi i një Statuti të Projekti 20% (Prezantimi në grup i përbërë nga 4 studentë)</p> <p>Provimi gjysëm-semesteral 20% (Test individual me pyetje me shumë opsione)</p> <p>Vijueshmëria dhe pjesëmarrja në ligjerata 10%</p> <p>Provimi final 50% (Test individual me pyetje me shumë opsione)</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Panariti S. (2017). Menaxhimi i Projekteve, Tiranë</li> <li>2. Huffadine, M. (1993). Project Management in Hotel and Resort Development, McGraw-Hill</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Larson, E.W. and Gray, C.F. (2018), Project management the managerial process, Seventh Edition, McGraw-Hill</li> <li>2. Project Management Institute. (2017). A guide to the Project Management Body of Knowledge (PMBOK guide) (6th ed.). Project Management Institute.</li> <li>3. Mulcahy, R. (2018). PMP Exam Prep, Ninth Edition, Minnetonka, Minnesota : RMC Publications.</li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<b>Hyrje në Menaxhimin e Projekteve</b>
<b>Java e dytë:</b>	<b>Mjedisi në të cilin funksionojnë projektet</b>
<b>Java e tretë:</b>	<b>Roli i Menaxheri të Projektit</b>
<b>Java e katërt:</b>	<b>Menaxhimi i Integritetit të Projektit</b>
<b>Java e pestë:</b>	<b>Menaxhimi i Fushëveprimit të Projektit</b>
<b>Java e gjashtë:</b>	<b>Prezantimi i një Statuti të Projektit (Prezantim Grupor)</b>
<b>Java e shtatë:</b>	<b>Menaxhimi i Kohës së Projektit</b>
<b>Java e tetë:</b>	<b>Menaxhimi i Kostos së Projektit</b>
<b>Java e nëntë:</b>	<b>Provimi gjysëm-semesteral</b>

<b>Java e dhjetë:</b>	<b>Menaxhimi i Cilësisë së Projektit</b>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<b>Menaxhimi i Burimeve Njerëzore të Projektit</b>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<b>Menaxhimi i Komunikimit në Projekt</b>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<b>Menaxhimi i Rrezikut në Projek</b>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<b>Menaxhimi i Prokurimit në Projekt</b>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Menaxhimi i Akterëve të Projektit</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<i>Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</i>